



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. 320/6 prot.

Tiranë më 17.03.2026

VENDIM

Nr. 12 datë 17.03.2026

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 21, pikat 1/b, 3 dhe 4 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”,

KONSTATOVA SE:

Avokati Maend Kullaj (në vijim “Ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 320 prot., datë 29.01.2026, ndaj Organit Publik Ministria e Drejtësisë (në vijim “Organi Publik”) me objekt *“Ankesë ndaj procesit të konsultimit publik RENJK 889 – projektligji për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal”*.

Ankuesi pas ankesës së paraqitur pranë Organit Publik dhe përgjigjes së marrë prej tij me shkresën nr. M-313/1 prot., datë 22.01.2026, nëpërmjet postës elektronike ka dërguar Formularin e Ankesës dhe dokumentacionin shoqërues pranë Zyrës së Komisionerit, nëpërmjet të cilës ka kërkuar:

“Zyra e Komisionerit të konstatojë shkeljet e ligjit nr. 146/2014 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë gjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar” (RENJK 889), sa i përket raportit të rezultateve të konsultimit publik dhe trajtimit të ankesës drejtuar titullarit.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, Komisioneri vlerëson se ankesa është depozituar në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 21, pika 1/b të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” (në vijim “Ligji 146/2014”), për shkak se projektakti është miratuar dhe, si i tillë Ankuesi legjitimohet në paraqitjen e saj në afat.

Pas vlerësimit paraprak të ankesës, në përputhje me pikën 3 të nenit 21 të Ligjit 146/2014 në të cilën citohet se *“...me marrjen e një ankese, Komisioneri i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrimet me shkrim brenda*

10 ditëve”, Komisioneri me shkresën nr. 320/1 prot., datë 04.02.2026 me objekt “Kërkesë për parashtrime”, ka kërkuar nga Organit Publik paraqitjen e parashtrimeve me shkrim brenda këtij afati.

Në vijim, Organi Publik, me shkresën nr. 818/1 prot., datë 18.02.2026 “Dërgohen parashtrimet për një ankesë në kuadër të konsultimit publik”, ka sqaruar lidhur me ndjekjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të parashikuar në Ligjin 146/2014 duke cituar ndër të tjera se:

“Në zbatim të dispozitave të mësipërme dhe sipas të dhënave në regjistrin elektronik, rezulton se projektakti është postuar më datë 23.10.2025 dhe data e mbylljes së konsultimit përmes këtij regjistri është 20.11.2025. Pra, qartësisht rezulton se është respektuar afati prej 20 ditësh pune i përcaktuar nga neni 15. Ndërkohë, në kushtet kur nuk është parashikuar zhvillimi i takimeve publike, neni 17 nuk mund të merret në shqyrtim.

Pra, siç është sqaruar në shkresën që Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë ankuesit, nga ana e këtij organi publik është ndjekur procedura e konsultimit konform parashikimit të ligjit nr.146/2014.....

Në lidhje me raportin e rezultateve të konsultimit publik, sillet në vëmendje se shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve parashikohet nga neni 19 i ligjit nr. 146/2014. Sipas pikës 2 të këtij neni parashikohet se shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit, i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara. Ndërsa sipas pikës 3, projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuar në nenin 11 të këtij ligji.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme, Ministria e Drejtësisë ka hartuar dhe publikuar raportin e konsultimit publik për këtë projektakt. Nga ky raport rezulton se çdo koment i ankuesit është shqyrtuar, si dhe është dhënë edhe përmbledhja e arsyeve për mospranimin e secilit prej tyre.”

Gjithashtu në vijim të shkresës së Zyrës së Komisionerit nr. 320/1 prot., datë 04.02.2026 “Kërkesë për parashtrime”, Ankuesi me shkresën datë 18.02.2026, protokolluar me tonën nr.320/2 prot., datë 18.02.2026 me objekt “Parashtrimet e ankuesit në lidhje me ankesën nr.320 prot., datë 29.01.2026”, ka paraqitur parashtrimet e tij lidhur me shkaqet e ankesës.

Referuar sa më sipër, nga shqyrtimi i parashtrimeve të Organit Publik dhe Ankuesit, Komisioneri vlerëson se veprimet e ndjekura janë në përputhje me parashikimet e Ligjit 146/2014, konkretisht:

Në lidhje me pretendimin e Ankuesit që Zyra e Komisionerit “të konstatojë shkeljet e ligjit nr. 146/2014 nga ana e Ministrisë së Drejtësisë gjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar” (RENJK 889), sa i përket raportit të rezultateve të konsultimit publik dhe trajtimit të ankesës drejtuar titullarit.”, Komisioneri pasi vlerësoi të gjithë dokumentacionin e administruar, konstaton se projektligji objekt ankimi është publikuar në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike së bashku me aktet

shoqëruese në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 6 të Ligjit 146/2014 dhe në respektim të afateve të parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji.

Komentet dhe rekomandimet janë pasqyruar në “Raportin e konsultimit publik për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar””, i cili është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, në përputhje me parashikimet e nenit 19 të Ligjit 146/2014.

Gjithashtu Ankuesi ka ushtruar të drejtën e tij për tu ankuar pranë titullarit të organit publik përgjegjës, në rastin konkret Ministria e Drejtësisë, për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, kur projektakti nuk ishte miratuar ende, sipas parashikimeve të nenit 21, pika 1/a, të Ligjit 146/2014. Organi publik, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, ka kthyer përgjigje me shkresën nr. M-313/1 prot., datë 22.01.2026. Përsa i përket marrjes në konsideratë të komenteve të ankuesit nga ana e Organit Publik, Komisioneri sqaron se ky vlerësim është jashtë kompetencave të tij, të përcaktuara në Ligjin 146/2014.

Në përfundim, bazuar në sa më sipër parashtruar, konsultimit të ligjit në tërësi, si dhe dispozitave të sipërcituara në veçanti, për sa lidhet me ushtrimin e kompetencave të Komisionerit sipas parashikimeve të nenit 21 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, vlerëson se nuk konstatohet shkelje e dispozitave të këtij ligji gjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar””.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 320 prot., datë 29.01.2026, të Avokatit Maend Kullaj kundër Organit Publik Ministria e Drejtësisë, me objekt “*Ankesë ndaj procesit të konsultimit publik RENJK 889 – projektligji për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal*”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
3. Ky vendim u shpall sot më datë 17.03.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi